



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno / Prodato Received / Delivered	23-01-2023	viti god year	3
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Hr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTOK	685/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1120/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Arditë Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen ankimore me numër A.nr.1120/2022 të datës 08.12.2022, të parashtruar nga ankuesi Milot Ismaili, me adresë banimi: Ulpianë U/1, Nr.15, në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministria e Punëve të Brendshme i datës 30.11.2022, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 23.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1120/2022 të datës 08.12.2022, të parashtruar nga ankuesi Milot Ismaili.

A r s y e t i m

Ankuesi Milot Ismaili, ka parashtruar ankesë me numër protokoli:7776/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1120/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 1080 të datës 30.11.2022 të Komisionit për Ankesa të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pretendimet ankimore se konkursi i datës 04.08.2022 për pozitën "Zyrtar Administrativ" ka qenë i njëanshëm, jo objektiv dhe i pa bazuar në meritat e kandidatëve të përzgjedhur.

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë së Ministria e Punëve të Brendshme duke u bazuar në nenin 79, 80 dhe 81 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, me datë 04.11.2022 ka shpallur

Konkursin për nëpunës administrativ dhe mbështetës për pozitën “zyrtar administrativ”, 50 pozita, me afat prej një viti.

Me dispozitat e Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht më nenin 2 është përcaktuar se; “...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa me nenin 82 po të këtij ligji është përcaktuar se “ Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës” rrjedhimisht po mbi këtë bazë ligjore është bërë edhe shpallja e Konkursit të kontestuar me ankesë.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, konstaton se nëpunësi administrativo-teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të filloj kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Kosovës si dhe nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, rrjedhimisht Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent që të shqyrtoj ankesat lidhur me kontestet e marrëdhënies së punës së nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, kështu që mbi këtë bazë, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit Milot Ismaili.

Andaj, marr parasysh konstatimin si me lartë së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1120/2022 të datës 08.12.2022, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit publik, i njëjti udhëzohet për inicim të kontestit gjyqësor në gjykatën kompetente në pajtim me dispozitat e Ligjit të Punës, pasi që lënda nuk mund të bartët të gjykata kompetente ngase në këtë fazë mungon padia si kusht kryesor për fillimin e një procesi gjyqësor.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1120/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit Milot Ismaili;*
- *Sekretarit të Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së;*

